



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1373\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2151\_03\_21** i dt.31.03.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **12.05.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.M nga Komuna e Gjilanit, me shifër të konsumatorit DGL - 86427, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2151\_03\_21, i datës 31.03.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 31.03.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2151\_03\_21 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit A.M nga Komuna e Gjilanit dhe e ka obliguar të Licencuarin KESCO që ta shkarkoj konsumatorin nga korrigjimi shtesë nr.24590DPR-86247 në vlerë prej 574.41 EUR.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Korrigjimi i dt. 09/2015 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, pasi që si pasojë e djegies së njehsorit është regjistruar vetëm 33.33% energji elektrike dhe pjesa e mbetur është përmirësuar përmes korrigjimit të faturave për gjashtë (6) muajt e fundit të faturimit;
- Punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr.1049515 ku kanë konstatuar se njehsori e ka të djegur sistemin e fazës R dhe S dhe si pasojë e kësaj ka regjistruar energji elektrike për 66.66% më pak.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2151\_03\_21 i datës 31.03.2021 për konsumatorin A.M.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që korigjimi shtesë i dt. 09/2015 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, Bordi si të tillë e vlerëson jo të qëndrueshëm dhe jo të bazuar në provat materiale të lëndës, sepse, duke u bazuar në Rrjedhën e Energjisë Elektrike, Bordi ka vënë re se konsumatori ka pasur dy njehsorë elektrik nr.10495515 dhe nr.16074869, si dhe vërehet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit me njehsorin nr.10495515 dhe me njehsorin e ri nr.16074869 nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike. Me qëllim të analizimit sa më mirë të shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik të vjetër nr.1495515 (njehsori kontestues) dhe njehsorit elektrik të ri nr.16074869 Bordi ka bërë krahasimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të dy njehsorëve elektrik për gjashtë muaj para dhe pas, për dymbëdhjetë muaj para dhe pas, si dhe për njëzetekatër muaj para dhe pas. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike: për periudhën gjashtëmujore mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.10495515 para periudhës kontestuese prej periudhës 02/2015 – 07/2015 ka qenë 638.17 kWh/muaj, ndërsa me njehsorin elektrik nr. 16074869 pas periudhës kontestuese 02/2016 – 07/2016 prej periudhës është 659.83 kWh/muaj; për periudhën dymbëdhjetë mujore mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.10495515 para periudhës kontestuese prej periudhës 08/2014 – 07/2015 ka qenë 653.42 kWh/muaj, ndërsa me njehsorin elektrik nr. 16074869 prej periudhës 09/2015 – 08/2016 pas periudhës kontestuese është 680.83 kWh/muaj; për periudhën njëzetekatër mujore mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.10495515 para periudhës kontestuese prej periudhës 08/2013 – 07/2015 ka qenë 633.79 kWh/muaj, ndërsa me njehsorin elektrik nr.16074869 prej periudhës 09/2015 – 08/2017 pas periudhës kontestuese është 685.50 kWh/muaj. Pra, nga kjo shihet qartë se nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike mes njehsorit të vjetër elektrik nr.10495515 dhe njehsorit të ri elektrik nr.1674869, e që po që se njehsori elektrik i vjetër nr.10495515 nuk do të kishte regjistruar energji elektrik për dy faza R dhe S atëherë me rregullimin e saj apo me ndërrimin e njehsorit, ajo energji e cila nuk është regjistruar do të duhej të reflektohej te njehsori i ri.

Po ashtu, duhet theksuar se bazuar në listat e leximit të KEDS të periudhës 04/2015 – 08/2015 shihet se lexuesi i KEDS ka bërë lexim të rregullt të pikës matëse. Në listën e leximit të periudhës 04/2015 lexuesi i KEDS ka evidentuar gjendjen e shpenzimit TL=45438 kWh dhe TU=57369 kWh, në periudhën 05/2015 është evidentuar gjendja TL=45609 kWh dhe TU=57937 kWh, në periudhën 06/2015 është evidentuar gjendja TL=45764 kWh dhe TU=58434 kWh, në periudhën 07/2015 është evidentuar gjendja TL=45957 kWh dhe TU=58966 kWh, në periudhën 08/2015 është evidentuar gjendja TL=46007 kWh dhe TU=59125 kWh (me njehsorin nr.10495515) dhe në periudhën 08/2015 është evidentuar gjendja TL=239 kWh dhe TU=111 kWh (me njehsorin nr.16074869).

Andaj, nën dritën e këtyre fakteve, Bordi vlerëson se Vendimi i DMK-së si shkallë e parë në ZRrE-së, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që si i tillë është i mbështetur në provat materiale si në shkresat e lëndës. Për më tepër, është e papranueshme që të pretendohet që një vendim të mbështetet në vetëm një provë të vetme, siç po tentohet të bëhet në rastin konkret nga i licencuari KESCO.



Bordi duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik, procesverbalin e kalibrimin, transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO nuk ka respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se:” **1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim” dhe mbi këtë bazë ka konstatuar se KESCO duhet ta shkarkojë konsumatorin nga korrigjimi shtesë nr.24590DPR-86427-86427 në vlerë prej 574.41€.**

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit A.M. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar